

BIBLIOTEKË

E

BIBLIOTEKA

854-1

B. S. S.

SHTETIT

GJIROKASTËR

SHOQËS

SYSHKENDI

891.983 -1

S

B55

BIBLIOTEKA E RINISË

BIJ TË SHQIPES
SYSHKËNDI

~~53623~~

~~BIBLIOTEKA E RINISË~~

17642

NËNËS SIME

Nëna ime, o parti,
që më more, më rrite në gji,
biri yt gjithmon' do t'jem,
do t'baj deken si me lemë.

Para armikut s'do t'përulem,
si lua' mbi te do t'sulem.
Sa her'ti të lshojsh kushtrim,
do t'përgjigjet gishti im.

Kjo asht fjala që premtova
n'gjirin tand kur u pranova.
Digjet bota, bahet tym,
por s'prapëson premtimi im.

Ndonse n'dallga un'kalova,
nanën kurr' nuk e harrova,
jo atë, që më bani e shkoi,
por atë që më edukoi.

Zanin «hakmarrje» do të ngre,
në qiell të shkojë tym'i zi,
për ata që ikën e shkuen,
të rit' e tyne nuk e gzuen.

Shkum' të dalë e uj' i zi
përmbi troje, mbi sergji;
vullkan bota le të ndizet
dersa armiku të përmbysset.

Shkodër, 29 gusht 1949

1) Kjo vjershë është kopjuar nga teksti origjinal, i cili ndodhet në muzeun e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

HEROI I HESHTUN

Ai s'asht kalorës, që trokon plot bujë,
s'andrron t'i ngrenë
statujë,
nuk asht vigan legjendash,
div. . .

Ndërgjegjen ruen gjithmonë të qelibartë,
ai mban, si dekoratën ma të lartë,
emnin
punëtor operativ.

Pa ngranë ai rri, kur asht i urritun,
ai rri pa pi, kur asht i etshëm,
ai vetë e ka zgjedhë detyr'n e ndritun
të partizanit të përjetshëm.

S'e ka zili
ofiqin e të famshmit detektiv, —
ai mban emnin e thjeshtë e pa stoli:
punëtor operativ.

Në çerdhe t'ujqve i duhej ujk me u dukë,
urrejtje e dashuni n'krahnor me i strukë.

Ai nuk ka gojë,
kur duhet nga hareja të thërrasë,
kur zemra i dhemb,
duhet të qeshë,
të flasë...
Por, kur banditët ai përdhe i përplas,
detyrën ndaj Atdheut ka krye si ushtar,
veten e ndjen
të lumtun
e krenar,
që ka nderue të çelniktin kolektiv
emnin e shtrenjtë:
punëtor operativ.
Partia i dha synin si shkendi',
një popull i dha grushtin si tërmet;
po ta kërkojë Shqipnia,
ai ban fli
fëmijët e vet.
Me sy shqiponje ai Atdheun ruen,
ai veshin vë në tokë
e hapat e anmiqve kjartë i shquen,
me shpatë të mprehtë u pret kokë e çapokë,
planet ua hedh në erë me eksploziv,
ngadhnyjes nëpër duele del përherë
kundër agjentësh t'egër e finokë,
ngre lart fener
emnin:
punëtor operativ.

Del ngadhnjimtar,
se çdo shqiptar, —
plaku i urtë njëqindvjeçar,
punëtorja, që sot normat kapërcen,
bariu vogëlush, që dhentë në mal mërzen, —
punëtor operativ veten e ndjen.

Si shtrëngim dore,
përçafim,
dëshroj kjo kangë të jetë për ty, vëlla,
në festën
tonë;
të jetë gjithnjë një i zjarhtë urim.
Sepse ka hak ma t'bukurin motiv
heroi i heshtun, që emnin ka:
punëtor operativ.

Llambro Ruci

DY PLAGË

Mirëmbërmani shokë,
mirëmbërmani shqiponja, që përgjoni errësirën,
dridhmën e erës, fëshfërimat e pëmëve.
hapat e armiqve muzgjeve.

Mirëmbërma ati im.

Unë sonte për ty do të tregoj,
ndonëse heshtja është e çmuar
tek ju, në Sigurim.

.

Ish dimër, viti 1943.

Qielli dridhej, lotonte. . .

Nga çdo vatër ngriheshin shtëllunga të zeza,
me gjymtyr' të frikshme të pushtonin horizontet,
dhe bashkë me to

ngriheshin lart në re

mallëkimet dhe grushtet e nënave tok shtrënguar.

Qielli lotonte,

ushtari gjerman të pafajshmin me kondak
në brinjë, në kokë e qëllonte.

Komisari çetën në mes të pyllit ka rreshtuar:
— Le të dalë nga radha një shok,
strofkat armike për të zbuluar!
Tridhjetë duar armët fort shtrëngojnë,
tridhjetë hapa rrahin njëheresh tokën e zjarhtë;
si një grusht i vetëm gjithë bashkë:
— Jemi gati dhe malet t'i rrëzojmë!

Vështirë e ka komisari të zgjedhë
mes trimave më trimin nga ata.
Dhe u nis partizani nëpër natë...
Fryn era, shiu e qëllon rreptë në fytyrë,
këmbadoras mes gurëve rrëshqiste.
Për Shqipërinë e lirë
asgjë në botë rrugën dot s'ja priste.

Ja postblloku me kryqin e thyer...
— Vështro, partizan!
Numëro grykat e zeza që nderen drejt qiellit...
Shokët presin sonte në mal.

Por krismat e thyen në mes numërimin,
në nishan vunë bustinën me yll të kuq.
Sa donte të derdhte urrejtjen partizani
mbi kopenë naziste, që pas tij po vinte!
Ja ndali dorën fjal'e komisarit:
— Qindra njerëz presin aty poshtë,

qindra zemra rrahin veç për ne.
Dhe në rënç diku përtokë,
gjeji forcat, veten mes armiqve mos e le.

Dhe arriti mes shokëve zvarrë-zvarrë.
Gjaku kraharorin e skuqte.
Ngriti kokën e foli dy fjalë:

— Lermëni mua,
merrni letrën nën këmishë, afër zemrës!

* * *

Nëndori erdhi në Shqipërinë tonë
një mëngjez, kur gjithë Atdheu shkëlqente
nga fishekzarët e fitores.

Beteja të reja çfaqeshin në horizonte
tok me muzgjet,
që donin me marka të huaja,
nga deti, ajri e toka,
të vinin pranë pozicioneve tona,
të ndiznin përsëri zjarret e botës së vjetër,
e botës që kish perënduar në nëndor.

Përsëri ish partizani maleve bridhte,
mes bandës me armiq ai heshtte,

veç syri i tij fijet e ngatërruara zgjidhte,
që nesër, nën t'hekurtin grusht diktatur'e
proletariatit,
të ulte në bankën e t'akuzuarve tradhëtarët.

— Alarm! —

thërret e dridhet majë shkëmbit diversanti
roje, —

një repart ushtarësh rrugën na ka prerë.

«I duhet dhënë fund kësaj loje»,

mendon ish partizani duke ecur në fund.

Rreshtohen banditët syzgurdulluar.

Ushtarët drejt pritës po vijnë.

— Të parin, — thërret kryetari, —
qëlloni oficerin që prin!

Ish partizani shtrëngon automatikun në duar,
drejt armiqve grykëzën e drejton:

— Nuk vriten, jo, katilë, prapa shpine
bijt' më të mirë të popullit tonë. —

Automatiku hijen e vdekjes u ngul banditëve me
radhë,

këndon arma ndër duart e fuqishme të popullit,
por pas krahëve dikush e mori në nishan...

* * *

Kështu u plagos dy herë babai im
nga armiqt' e kësaj toke larë me gjak,

por kurrë se' la pozicionin në luftim,
nëpër erë, shi e në shtrëngatë,
se fener ndriçues në rrugë është partia
e fjal'e saj na thotë
sa e madhe, e fuqishme është Shqipëria!

SYRI I PAGJUMË I KOHES

*Kushtuar
punonjësve të organeve
të Sigurimit të Shtetit*

1

Mes tymit që shpalosej valë-valë
e nxinte mbi fortina e gërmadha,
nga gjiri i tufanit duke dalë,
u sulëm ne
drejt ditëve të bardha.

U sulëm para ne,
heronjtë e heshtur
në shtigjet, që partia ndriste
me busullën e saj në dorën e hekurt,
në zemër — idealet komuniste.

Me armën që lëshonte afsh të nxehtë,
me vetullat përzhitur nga baruti,
u nisëm,
ndoqëm hijet nëpër net,
e rruga
mes armiqve
prapë na futi.

Tani ata
fytyrë tjetër kishin:
mbi krye s'mbanin pendë,
kryqe të thyera,
dhe si hajmali nuk varnin «Jezu Krishtin»,
porse floring
rreth fytit të mbërthyer.

2

Ishte në fillim atëhere
Shqipëria,
me kazm'e këngë ngrihej që me natë,
ndërsa tradhëtarët ngrinin qeverira
dhe «miqtë» na llogarisnin si një kafshatë.

Po nuk ishte e lehtë, jo!
Republika kish hedhur rrënjë të hekurta,
të thella,

dhe ngriheshin lart
shkolla dhe fabrika,
nga drita e së ardhmes të mbështjella.

Pa niseshin fshatarët të bashkuar
në ara për të mbjellë lumturinë,
dhe, si flamur zjarresh të pashuar,
ne pamë kaqe fitore të na vijnë.

Pa ngritëm hekurudha,
thamë këneta,
mësuam A B C-në ndër baraka,
ja thoshte çiftelia dhe gërneta,
në sytë tanë pasqyrohej flaka.

Përpara çamë;
rruga s'ish e lehtë,
stafetën gjer në fund duhej ta çonim,
me pushkën, që lëshonte afsh të nxehtë,
me dashurinë për revolucionin.

3

E kur ndërtonim rrugët, veprat tona,
e mbi lumenj lëshonim perde digash,
ata, ndërsyer,

orëve të vona
ndërtonin, për Atdhenë,
kala intrigash;

dhe thurnin gardhe planesh zotërinjtë,
vërshimin triumfonjës të pengonin,
këlyshët e kompleteve të zeza
ushqente Londra,

Belgradi,
Roma,
Pentagoni!

Kufitë
si bisha i kafshonin bandat,
e radiot villnin vrer si gjarpërinj,
ata e mbanin hartën tonë ndër çanta,
por eshtrat këto shkrepa ua përpinë.

Dhe netve
ne pamë mbi dhe të binin,
porsi kërpudha helmi, parachutat,
dhe pamë vdekjen gjysmë leku ta blinin
«Heronjtë» e tyre,
minjtë që zinin skutat.

Pas shkurreve,
në qoshe, guva i kapëm

ata që rrotull brezit mbanin thikat,
që donin të godisnin tinës, natën,
të digjin lulet, shkollat dhe fabrikat;
ata që
në shumë «furra» kishin hyrë,
dhe disa gjuhë kapnin menjëherë,
por vetëm shqipen nuk e dinin mirë,
ndonëse ndokush
në këtë dhe kish lerë.

4

Jetojmë ne
mes njerëzve përherë
e mbrojmë këto fusha, këtë diell,
e mbrojmë këtë jetë kaqë të gjerë
në këtë tokë të begatë,
djep lavdie.

Dhe janë krahët tanë të fuqishëm
fshatari e punëtori,
pionieri!

Pa ta,
shqipe pa flatra ne do ishim;
me ta,
fuqia jonë kurrë s'do shterë.

LIBRERIA E SHTETIT
TIRANË

54623
11642
17

Kështu, mes tyre,
të pathyeshëm jemi.
E çdo cantim të truallit të shtrenjtë
një varr ne do ta bëjmë për të «paemrin!»
Nën këmbë do ta djegë çdo gur,
çdo rrënjë.

5

Ne jemi
syri i pagjumë i kohës,
radar i vigjilencës popullore.
si flakadane sulemi mes llohës;
gjithë jeta jonë është një llogore.

Mbi supe kemi
madhësinë e malit,
vrullin e vendit,
ngrohtësinë e zjarrit,
buzëqeshjen që mbi vdekjen ndezi Pali,
vështrimin rrezellonjës të Hajdarit.

I duam fort ne
këto ditë të ngrohta,
malet me borë dhe brigjet e rivierës,
i duam fort ne
lisat dhe mimozat.

Lumenjtë plot ujë dhe rrugët plot njerëz
ndër deje
dallgë energjish na linden;
nga toka marrim forcë
në çdo hap tonin,
se e duam fort ne
jetën, socializmin,
se dashurojmë fort revolucionin.

Llambro Ruci

KUFITARI I PARË

Ish partizani,
që zbriti nga malet me pushkën në sup
me këngët e fitores në buzë,
dhe vigjilent si bir i partisë që e rriti,
pozicion të ri zuri bri një grumbulli me gurë.

Nuk arriti të përqaftonte vajzën e vogël, Lirinë,
që çdo darkë me sytë nga porta priste babin e
mallëngjyer.

Unë nuk e pashë atë, kufitarin e parë,
që ra në përleshje me armiqtë
duke skuqur ballin e lapidarit të bardhë.
Por si gjithë Atdheu ndjej çdo çast, çdo ditë,
zemrat e zjarra të brezave që patrollojnë këtu,
bri ujrave, uzinave dhe gëzimeve të Republikës
duke kaluar dorë më dorë
pushkën e shtrenjtë të ish partizanit që ra

dhe duke kaluar zemër më zemër
fjalët e fundit që ai tha:

— Atdhe, popull, parti,
edhe të vdekur këtu në kufi
më kini kala!

«SHIKO, O PAL...»

*Dëshmorit kufitar
Llesh Palit*

Kolona jonë kalon shtegut të heshtur,
mes mjergullës së kaltër të mëngjezit.
Të ngjan kjo tokë e rëndë krejt e hekurt,
kur hapin ushtarët tonë të sigurt hedhin.

Këtu kalon kufiri përmbi kreshtë
dhe hap një lumë të thellë, të padukshëm;
dhe hap një hon ku hasmët vdekjen gjetën
nga grushti i shqiptarit të patundshëm.

Mbi veshjet tona qesh blerimi i tokës,
kur në bregore ne postroje dalim
për të vështruar horizontin tonë,
për të kënduar këngën e Llesh Palit.

Shiko, o Pal, shiko sa jet'e bukur!
Kjo kaltërsi e qelqtë kurrë s'do erret.
Shih në pranverë si qesh gruri dhe bujku
dhe pesëvjeçarët lart po ngrenë kantieret.

U rritën mbi Atdhe krenarë oxhakët;
shtyllat e sondat; zbardhin lapidarët,
sepse më fort shtrëngojmë pushkën dhe kazmën,
se jemi ne ndërtonjës dhe ushtarë.

* * *

Dua të thur aq shumë këngë, o Pal,
për ty e për heroizmin kufitar,
por vepra juaj, shokë, s'do shumë fjalë,
andaj ju them: jam e do mbetem ushtar.

HEKURAN ZENUNIT

Era çirret,
ai ngjitet;
bora shtrin çarçafn'e bardhë,
gjëmon mali,
ret'i gris një vetëtimë,
s'jepet djali.

— Kthehu prapa! — gulçon era,
bora qetë këshillon:
— Ndal në vend, a s'e shikon?
Mal'i egër, hijerëndë,
uturon:
— Prapa kthehu, më dëgjon?
Buzëgaz ky Hekurani
ç'u përgjigjet:

— A dëgjon, o mal'i lartë,
bor'e bardhë e er'e rreptë,
prapa s'kthehem;

atje lart më presin shokët,
jam ushtar'e kam detyrë.

Bora shtron savan' e bardhë,
tokë s'duket asgjekundi.

— Ku po shkon ti fillikat?
Kthehu prapa!
E ndjek bora e tufani
hap më hap.

— Ikë tutje, er'e marrë,
ti, tufan e bor'e bardhë,
nuk jam vetëm,
kam me vete un'partinë.
E partia është'tufan,
uragan!
Pra, largohu.

Bora bie.
Ai ngrihet e s'përkulet.
Mali i lartë, kryethinjur,
trimërisë i përulet,
edhe pyjet, plot habi,
sikur pyesin:
— Kush je ti që mund tufanë,
kë ke mëmë?

— Kam partinë gjithmonë pranë,
kam ushtrinë.

Kam Atdhenë,
prandaj s'kthehem prapa kurrë,
se jam burrë
e përpara do të shkoj
përgjithmonë.

PO VJEN VELLAI I TRIMIT

*Kushtuar kufitarëve
Agron e Mehmet Elezi*

Te kodra buzë lumit;
në roje të Atdheut
vrojton një kufitar.
Asgjë nuk ja tremb syrin;
në zemër — mëmëdheu,
partinë e ka fanar.

...Në pikën e vrojtimit,
i pastër kishte mbërritur
mëngjezi i asaj dite.
Atje... brezi i kufirit,
që ndan Kalanë e kuqe
nga tok'e kredhur n'halle,

kaq vjete e tradhëtuar
prej klikës sërbomadhe...

Papritur, një lëkundie!
Dhe dridhet gjithë dheu,
soleta po shkëputet
e muret i rrëmbeu;
u ça në mes ndërtesa,
po kufitari s'tutet.

Në xhamin e dvlbisë
po ngjan një hi'e zezë,
që dridhet nga llahtari:
— Pa hidhu nga vendroja,
shpëto veten, o burrë.
Po rreptë ja kthen ushtari:
— Unë jam bir i partisë
dhe trimat s'jepen kurrë!

...I shpejt' si vetëtima
sinjali ka vërshuar.
I madh edhe i vogël
te kulla paskan rendur.
Po zemra... kish pushuar!
Majë kodrës, në vrojtim,
ra trimi sypatrembur.

I pastër e i qeshur
 mëngjezi prap avitet.
 — Po vjen vëllai i trimit. —
 Janë mbledhur malësorët.
 Flamur'i kuq valavitet
 në pikën e vrojtimit.

Me kokën lart Mehmeti
 radhitet sot ushtar,
 ai që nëpër net
 ka ecur mes thëllimit,
 qëndron gjithnjë krenar
 në rroje të kufirit.

Qëndron ai në radhë
 me armën e vëllait.
 Çdo zemër ndizet zjarr.
 Mehmeti sjell ndërmend
 sot fjalët e babait.

— Fëmija edhe plaku,
 një popull sypatrembur
 e mbron sot këtë tokë.

Në gjokse kemi llavë,
në sy — drit'vetëtime!
Dhe s'tundemi nga shqotat.
Partia lavdiplote
i prin shqiponjat trime.

UNË DHE LAPIDARI

Bregut, nëpër erë,
të zhveshura degët u drodhën me shqetësim.
Dy plumba vërshtëllayen tek mbushte ujë një
pabesisht ra një trim. kufitar;

Nuk qau kush si shelg lotues i thinjur,
Nuk qau as nëna djalit duke thirrur,
po një yll
edhe një gur
u vendos n'atë vend.

Atë yll në kokë e kam un' ushtar'i ri.
Ai gur i tmerrshëm për armiqt' u rrit, u rrit...
dhe të dy bëjmë roje na këtu në kufi:
unë dhe ky lapidar granit q'u ngrit.

MBARË POPULLI BËN ROJE

Një mik më tregoi ndodhinë
të cilën në vargje po e shkruaj:
Ishte natë... e prishi qetësinë
një «sorrë» e zezë, e huaj.

E prisnin këtë trimat pa gdhirë,
ndaj dhe, si «miq», u bashkuan,
u shtinë, ashtu, me pahir
sikur Atdheun tradhëtuan.

«Sorr'e zezë» filloi transmetimin:
«Jam mirë, o shokë, me shëndet,
edhe konditat janë; zbarkimin
e nisni me shpejt në det.

Kam gjetur këtu shokë besnikë,
ca burra të fortë të vendit.
Ngurrim ju mos kini, as frikë,
takimin te shkëmbi mes detit».

* * *

Përplasheshin valët e egra,
mënt çahëj anija,
por s'trembeshin zemrat e hekurta,
me ta ishte pranë partia.

Arritën së fundi mes detit
dhe hipën në shkëmbin e lartë. . .

. . . Nga larg një fener ndriçoi
mes detit, që shfrynte tërbuar;
prej barke llastiku zbarkoi
skudadër e spiunve t'mallkuar.

Sa zbritën në tokën shqiptare,
të shtangur seç mbetën, të ngrirë,
se trimat, me t'parën batare,
tre veta i lanë të shtrirë.

.

Anija sërishmi në det
stuhinë e çan me furi;
Atdheu me zemër përshëndet
gjith' trimat mbuluar në lavdi.

MIDIS TYRE DHE UNË, KUFITARI

Më pëlqejnë agimet e arta, Myzeqe,
që i shpërthejnë si furtunë
vrullet rinore.

Djersa e kulluar rrjedh rrëke
mbi trase
nga kraht' e rinisë,
nga forcat muskulore.

Më pëlqejnë dhe mbrëmjet e tua, Myzeqe,
qytezat,
ku dëfren e çlodhet vullnetari.
Prit krahëhapur, në gjirin tënd, si një
këngë të re,
turnet vullnetare;
midis tyre jam dhe unë, kufitari.

KUR VJEN KOMISARI

Kur vjen në mëngjez komisari
dhe na përshëndet,
reparti, i gatshëm
në rresht,
ngul syrin në syrin e tij;
me mushkëritë e Atdheut merr frymë
dhe do patjetër të dijë:
brigadat vullnetare në mbërritën në Dibër,
në punuan turnet të qetë,
a u mbollën të fundit dynyme,
a në doli broshura me plenumin e tretë.
Dhe do patjetër të dijë
Urdhërin e Ditës
që Atdheu i jep
me gojën e tij!

SHTËPIA BRI PYLLIT

Bri pyllit, që oshëtin dit'e natë,
një shtëpizë e vogël ngrihet;
atje brenda, me ballin lart,
një familje trimash mblidhet,

një familje e urtë, e thjeshtë,
një familje e dashur për miqtë,
por që shoqe bëhet me rrufetë,
kur tokën e shkelin armiqtë!

USHTARI YNË NË KUFİ

Ushtari ynë në kufi
si një lis vigan,
që rrënjët ka shtrirë thellë tokës mëmë,
që dhe tufan i Saharës s'e mposht dot,
që dhe rrufeja në e qëlloftë,
mbetet prap shtatlartë në tokën mëmë.

MOS GUXO

Spiun!

Ti tenton të depërtosh,
porse të dridhen leqet e këmbëve
gjithë nerva shiatikë,
gjithë nerva të dëmtuara,
të shkatërruara ndër shkolla spiunazhi.
E di.

Kërkon të kryesh misione misterioze,
këtej të hidhesh...
Veç mos harro,
se, po kalove dy çape më këtej,
atëhere,
përshëndetjen e fundit ju dhe kabareve,
kupave plot uiski dhe shampanjë,
amoreve, krimeve, dollarëve.

Për dy çape më këtej,
të përvëlton atdheu i shqiponjave!

Për dy çape më këtej —
a më dëgjon, spiun? —
breshëri dalin plumbat;
bashk' me shkëndijat gjëmojnë dhe kodrat,
ndizet ky truall i Enverit
zjarr e flakë,
ndaj mos guxo!

Namik Dokle

PIRAMIDA DHE LAPIDARI

Në dhomë 17 kufitarë,
17 yje në ballë,
17 kapota ushtare,
e, nën kapota, vallë sa ëndërra flenë?!
Ëndërra të bukura aty kanë folenë.
Ëndërra që flenë?!
Nuk flenë ëndërrat kufitare,
jetojnë trimëreshat ëndërra,

* * *

Në çast hapet dera.
— Shokë, — komandanti foli, —
Jeni gati? Ju thërret Atdheu... —
— Gati jemi; — bjeshkët fort ushtuan.
17 janë më të fortë se malet.
17 pushkë në gjokse shtrënguan,
17 yje fort në ball' shkëlqyen.

Si shqipe, kufitarët jasht'u turrën,
darë e fortë në tokë kufitare,
darë çeliku gjoksesh kufitare.
«Ndal, armik! Duart lart!
Dara jonë s'kalohet dot,
ka ajo shtrënguar 17 gjokse
ka ajo ngulur 17 zemra,
ka flijuar 17 zemra,
17 pushkë të ka drejtuar...
Ndal, armik! Duart lart!»

Duket sikur malet po ushtojnë
e luginat rrebtshëm po jehojnë;
stuhi e maleve,
e dimrit stuhi,
për të liqtë
këndon të vdekjes simfoni.

Hijet mbeten,
si n'baltinë bretkosat,
por një bretkosë lëvizi
e natën tej e çori.

Ah! Plumb i zi,
trimin Sokol në gjoks e mori,
gjoksin ja përvëloi.
Hija prapë lëvizi,

mashinkën duart prapë shtrëngojnë
dhe një breshëri e shkurt' e shtangu natën,
dhe hija mbet. . .

* * *

Mëngjez i ftohtë.
I akullti mëngjez qenka zgjuar.
Grimcat e borës si margaritarë
shkëlqejnë dhe sytë të vrasin.
Era ka pushuar,
bora përreth e përgjakur.
Njëra dorë e trimit Sokol
mashinkën fort shtrëngon,
tjetra dorë në gji
shtrëngon dokumentin.

Lajmi mori dhenë.
Ra kufitari!
Zemrat e njerëzve u drodhën.
Babai i Sokolit zemrën shkëmb e bëri,
lot nuk derdhi, se s'vajtohen trimat,
se nuk vdesin trimat, rrojnë ata kudo,
se përjetë ata në këngë këndohen.

* * *

16 shokë. . .
Të shtatëmbëdhjetin po përcjellin.

16 shokë...

16 dhimbje...

16 pushkë po ngrihen lart në ajër,
në shenj' nderimi jan'bërë gati.

Dorën komandanti ka ngritur.

«Gati! Në shenj' nderimi...»

Fjalën s'e mbaron.

Një zë i dhimbshëm prindi
urdhërin e ndalon:

— Shoku komandant!

17 ishin ata,

17 pushkë t'ma përcjellin birin.

Unë dhe një djalë e kam,

falë ja paça partisë,

Atdheut falë i qoftë!

Shoku komandant!

17 ishin,

17 le të mbesin.

Preng, lum baba,

merre t'vllaut pushkën!

Tund kryet djali krenarisht,

po, sado burrë, një lot në sy i shndrit,

dhe baba ashpër djalit ja hedh sytë.

«Babë, më fal!.. Por vëlla e kam...»
duket sikur thonë sytë.
Zbutet baba, lehtas e luan kryet
edhe djali pushkën e shtrëngon.

.

Piramida edhe lapidari
jan' dy yje që qëndrojnë mbi malet,
jan' dy yje t'kuq që kurr' nuk shuhen,
jan' dy lule t'bardha që nuk vyshken.
Piramida edhe lapidari!
Midis tyre ecën drejt kufitari!

Nikollë Spathari

LEKA

I t'an katundi, grat'e burrnia,
del me nis Lekën, si zakon
e ka pasun dhe e ka Malësia,
kur prej katundit kush ushtar shkon.

«Ty, or bir, nan'lokja për jet' t'pastë,
— i tha plaka përmallshëm shqim, —
kurgja n'bot' o zemër, s'jam tue drashtë.
veçse banju lokes kufitar trim».

* * *

Trimnueshëm Leka i prin njësitit
me arm' në dorë, me zjarr e zemër,
don t'zajë tradhëtarët ky zog petritit,
që shkel' kufinin e kan' ba emën.

Te një gryk' shpelle gjurmët mbarojnë:
me bujt' anmiqt' aty kan'hy.

Daljen e shpellës ushtarët rrethojnë,
keqas anmikun mbrend e kan'ndry.

At'hera t'plasi pushka batare,
mbush edhe qitë ushtarët pa da,
po aqë shpejt dora tradhëtare
i lshon plumbat nëpër hava.

Erdhi nata, majat kaloi dielli.
Pak si t'ftoht' nga mbramja asht'tue ba;
n'an' t'prendimit bukur asht' kuq qielli
e prej malit kthejn' barijt' me gjah.

Dhe pran'votrës, ku shpesh Leka i kndonte
i gzueshëm punës, Shqipnisë,
t'gjithë rreth zjarmit, që bubulonte,
ishin mbledhun njerëzit e shtëpisë.

Kur papritmas at'her'dera trokiti.
— Po dal un', — i tha lokja t'birit, —
sepse s'dihet nata se kë qit,
nuk i dihet mendja mysafirit.

— Hape, o loke, se s'jam asi njerit;
si s'e hoqe ma at'frig' t'vjetër?
— u dëgjue at'her'zani i postierit,
që me vedi kishte sjell'nji letër.

S'ishte letra porsi letra tjera,
me makin' adresa ishte shkrue.
— Kush e din, — tha lokja, — ç'ka sjell'era,
veç gja e keqe ndoshta s'ka me qëllue.

Por letra s'kishte lajme t'kqia;
sokol malit Lekën e emnonte.
Çue ja kish lokes ministria,
me gjith'zemër at'e falnderonte.

Tuj dëgjue me ankth nana plakë,
thue ju zhdukën krejt rrudhat e ballit,
faqja e vyshkun ju ba e kuqe flakë,
nëpër mollëzat rrodhën lot't e mallit.

.

Lindi dielli përmes malit,
u hap lajmi nëpër fshat,
se këtij Lekës, sokol djalit,
i ka ndesh i bardhi fat.

Vet' trimnia dhe guximi
ja kan' sjell' t'madhe fitore,
e lavdrojshin krejt burrnia,
si edhe cucat malësore.

Pal Perlala

EDHE VDEK PËRGJON N'KUFI

Hesht ai, hesht e nuk flet,
mbi një gur kokën mbështet,
pushkën ende mban në dorë,
ndonse n'gjak i skuqun krejt.

...Plot dy or' ushtari trim,
përmes pyllit, në thëllim,
me një bandë diversantësh
luftoi, po, me guxim;
tre prej tyne la të vrarë
përmbi dushkun që ish tha,

por, ah! ja, një plumb në ballë
e zu trimin, edhe... ra!
Ndaj nuk flet, por hesht ai
dhe shikon në largësi.

...Pushkën ende mban në dorë:
edhe vdek'përgjon n'kufi.

AI ASHT ME NE

Nxin Shkopeti porsi hon,
nata sa ka ra.
«Diversant, sonte ç'kërkon,
cilin do me vra?»

Ndal, këlysh i tradhëtisë,
mos kalo mbi zall,
ke një trim të policisë
sonte ball' për ballë!»

Preng Gjet Tusha, trim rrufe,
zanun ka pusi,
mbi anmikun fort po shtie,
dridhet bjeshk' e vrri;

dhe granatat varg e varg
përmbi të po i hedh,
dhe e shtrini mbyt në gjak
diversantin n'ledh;

Po një kriminel ka mbetë,
përmbi shkamb ka hyp,
Prengën e qëlloi — medet! —
me mauzer në fyt.

Ra sokoli i policisë,
krejt në gjak u la,
në detyrën e partisë
trimi jetën dha.

Por nuk vdes, nuk vdes ai,
në mes nesh jeton,
porsi ylli në stuhi,
që ma fort ndriçon.

Dhe, kur roje ne qëndrojmë,
roje për Atdhe,
prap' me Prengën vigjilojmë,
ai asht me ne!

O KANGË, JEHO

N'oborr t'repartit orkestra ka dalë,
tinguj t'gzueshëm sulen në re,
malësoni e labi me t'artat fjalë
këndojnë, këngën e lashtë, këngën e re.

Bjeri gërnetës, që fort të ushtojë,
si bori e luftës çlirimtare,
së bashku me ty sot do të këndojë
këngën e jetës çdo zemër shqiptare.

N'zemër kemi prush revolucionit,
në dorë kallo dhe n'deje gjak të ri.
Të mbrojmë Atdhenë — ky është misioni —
dhe tok partisë t'i ngremë dolli.

O gjenerata ime, vigjilo
dhe bjeri gërnetës me hov të ri!
Fort për partinë, o këngë jeho,
se je relik'e Kongresit të ri!

PAVDEKËSI

*Kufitarit Hero i Popullit,
Nik Ndrekës, i cili ra heroikisht
në përpjekje me diversantët:*

Ata ishin tre; gjer n'dhëmbë t'armatosur.
Ti me një çifteli edhe një kërrabë,
por para syve të tyre, o Hero vermoshas,
ngrihesh përmbi male, siç ngrihet çdo shkabë!

«Na trego shtegun... rrugën e kufirit,
përndryshe, piciruk, të pret gremina...»
Ti larg pe. Delet të mbuluan me blegërima,
delet që kullosnin të gëzuara ndër rudina.

«Të japim ç'të duash... kupton, ç'të duash!
Derdheshin tradhtarët me premtimin joshës,

por ç'ishte vallë dhurata para Atdheut?
Ndaj gjoksin thikës i drejtove, kryetrim
vermoshas.

Ti heshte dhe fole aq sa flasin malet,
sa flasin para armiqve bijt'e partisë,
i përgjakur re në këngën tonë të madhe,
hyre në këngën e madhe të pavdekësisë!

KËNGA E LIRISË

Ai i binte aq mirë çiftelisë
buzë zjarrit, tek binte nata,
dhe na kujtonte vatrën e shtëpisë,
dhe heshtëte rreth tij gjithë brigada.

Ai dhe këndonte me t'ëmbilin zë
për dashurinë e nënave;
dhe vinin pranë nesh flokëthinjurat
e u njomnin faqet bijve.

Ai këndonte për trimat dëshmorë,
vraponte brigada pas tij,
dhe kënga ngrihej mbi malet me borë,
kënga e Qemalit, e Vojos për liri;

dhe kënga na ndiqte shtigjesh partizane,
na ngrohte zemrën n'borë e kallkan.
Me këngë sulmuam bishën gjermane,
me këngë në gojë jetën dhamë.

Po ja se plumbi, plumbi i zi,
atë e mori n'ugar te ara,
T'fundit tingull lshove, çifteli,
sikur këndove: «Partizanë, përpara!».

Dhe ra ai, mbi këngët e tia.
I rrodhi gjaku n'gropë t'çiftelisë.
Nga vrulli i gjakut jehoi çiftelia
e nisi kënga e madhe e Lirisë.

TREGIM PËR KUFITARET

.
Gjashtëdhjetë vite mbushi
këtë vjeshtë Ram Sadushi,
e belxhikun që ka pranë,
tok me trimat partizanë,
mijra herë e ka shkrehur,
edhe rishtas e mban ngrehur,
se armiqtë kurrë s'fllenë.

Grykëhollën nis ta fshijë,
e çibukun të thëthijë
hera-herës nga një grimë,
porse, befas, një trokimë
ndien që jashtë, e në derë
del të shohë menjëherë.

Adriana dhe Aliu,
sa e panë, i treguan

përsa panë dhe dëgjuan,
n'atë shpellë, rrëzë shpatit,
kur po shkonin udhës fshatit.
Pastaj letrën shpejt i japin
e për dere vocërrakët
për në shkollë mbajtën vrapin.

Si shkoqiti letrën mirë,
grykëhollën që rrin shtrirë,
(në çdo anë e vajisur)
Ram Sadushi hedh në krah
Edhe zbret nëpër shkallë,
del përjashta në mëhallë,
hedh alarmin. Fulikare
vijnë njësitet vullnetare,
grykëhollat hedhur shpinës
dhe i ngjiten malit Glinës;
Ram Sadushi prinë në ballë.
Bri një shkëmbi, si arrijnë,
ndiejnë hapa që po vijnë,
e, pas pakëz, vrik u dhanë
kufitarët aty pranë.
Toger Shpendi rri më këmbë,
tregon vendin me pëllëmbë,
pikat kyçe ku t'i zënë,
edhe hasmin mos ta lënë,
lumin, pyllin të kalojë...

Ujku, thonë, kërkon mjergull,
edhe hasmi herë-herë,
ruan netët në poterë,
se të artat rreze ditën
i verbojnë hasmit dritën,
ndaj dhe banda priti natën
për të dalë nga limeri,
për të mbjell'ajo mandatën...

Shtegut t'dhenve, si kusarë,
diversantët hiqen zvarrë,
por papritur, vetëtimë,
krisma pushkësh oshëtinë.
Mes panikut, të tmerruar,
diversantët, të hutuar,
me të shtëna tundin malin,
nga rrethimi që të dalin.

Kufitarët, në çdo pritë,
po i shtojnë breshëritë,
e kur banda tek zvarritet,
drejt pusisë kur avitet,
kapter Lusha, nëpër natë,
u vërvit një granatë,
u vërvit gjasht'a shtatë...
Diversantët, në rrëpirë,
porsi shakuj mbetën shtrirë.

Dhe të fundit, që shpëtoi,
Ram Sadushi e qëlloi
n'pritrn e vet kur i kaloi.
Dhe këtë herë, si kurdoherë,
pushk' e tij s'e turpëroi.

AI

E dhjeta natë janari.
...Në këtë orë,
Tirana ndërron turnet në çdo anë.
Bora ka mbuluar Dajtin plak.
Mes brymës krihen shelgjet
përmbi Lanë.

Bën ftohtë.
Kudo jan' ulur grilat;
te sheshi Skënderbej
mesnatë tregon sahati;
përballë
— kolos plot madhështi—
qëndron Pallati i kulturës, i ri.

Qyteti
lëvrin në këtë orë nga turni i natës,
andaj për disa çaste nuk ka qetësi,

rrugët mbushen
përmbi asfalt
rrallë shket ndonjë taksi.

Ndonëse ftohtë bën,
n'apartamentet tona
ka këng'e ngrohtësi.
Thëllimi rreh ngado, si me kamzhik,
por në këto orë të vona
zbrazen sa dolli:
të gjithë kremtojnë festën tënde,
o nëna Republikë!

Në këtë natë,
të gjithë kremtojnë brenda;
për prijësen e dashur,
—të shtrenjtën tonë parti;
Po... duke ecur në asfalt,
përmes thëllimit,
qëndron i vetëm
veç një: Ai.

N'atë fytyrë të njohur
mërzitje apo lodhje
kurrë nuk dallojmë;
ai përpara tyre është vigan,
ato i tret detyr' e tij fisnike.

Ai është ushtar i çështjes së partisë
dhe bir'i popullit,
që mbart mbi supe
misionin delikat, detyrën aq epike!

Ai bën roje natën,
dhe ndodh
që shpesh ta shohim edhe të menduar.
Gjithmonë është' në lëvizje
(nuk dihet ku).
Ja sonte... mes thëllimit
shëtiti në lagjen time i vetmuar,
me pelerinën mbërthyer
mbi uniformën blu.

Në këtë natë,
të gjith' kremtojnë brenda;
nga zemrat thuren këngë
për prijësen e dashur,
nënë tonë parti!
Po... duke ecur në asfalt,
në shi, në erë,
po veç me zemër zjarr edhe krenar,
qëndron i vetëm
një: Ai!

TË PËRSHENDES

1

Mirëmëngjez,
shoku polic!
E di,
sapo je kthyer nga shërbimi;
e shoh në fytyrën tënde të zbetë...
se kjo natë për ty
nuk ka qenë e qetë.

Ti lodhje s'ndjen,
ecën plot gjallëri,
plot jetë.
Gëzim shikoj në syt'e tu,
po, kështu ndodh
gjithmonë me ju.

2

Ti gjith' natën
kalon përjashta
e s'pyet nga shtrëngata,

qëndron gati, krenar,
me zemër zjarr!

3

Kalon pranë meje
e unë të përshëndes,
të gjithë të përshëndesin,
me ndjenjën e respektit
e të dashurisë:
«Mirëmëngjez,
mirëmëngjez, o biri i partisë!».
Gjith' njerëzit të nderojnë
dhe ti ata nderon,
sepse ti, shok
me uniformën blu,
çdo dit' ata i mbron.

4

Të do ty
edhe vogëlushi im,
që humbi një ditë
e qante me trishtim.
Ti pranë i vajte
dhe e pushtove,

e përkëdhele, si babai të birin,
në krah e more, si fëmijë,
syçkat e njomur të vogëlushit
puthe
dhe i the: — Shkojmë në shtëpi.

5

I veshur
me kostumin blu,
me armë e rripin për mesin,
kalon çdo ditë.
Unë të përshëndes,
të gjithë të përshëndesin,
me ndjenjën e respektit
dhe të dashurisë,
«Mirëmëngjez, o bir'i partisë»

POLICI I TRAFIKUT

Në udhëkryq qëndron polici,
mbështjellë me mushama të gjatë,
në dimër, vjeshtë dhe në verë,
në shi e breshër, ditë e natë.

Maqinat vijnë nga çdo anë,
vijnë ngado, shkojnë ngado.
Ai zgjat dorën dhe bën shenjë:
— Maqinë, stop,
maqinë, kalo!

Vijnë kamionat e ngarkuar
me krom, qymyr apo me tulla;
pulsi dhe ritmi i Republikës
ndihet gjer në mesnatë te udha,

dhe vazhdimisht ai bën me dorë,
drejton lëvizjen vazhdimisht,

në punën tonë madhështore,
pjestar ndjen veten sigurisht.

Mëngjezi vjen, zien prapë jeta.
Në udhëkryq ai del prapë
dhe krahun zgjat në çdo drejtim,
veshur me mushamanë e gjatë.

AI ËSHTË ME NE KUDO

Atë unë e shikoj
çdo ditë tek mat,
me hapn'e tij, që troket n'asfalt,
qetësinë tonë.
Sa herë që dëgjoj
hapat e tij,
mendoj,
që atë ritm ta derdh në poezi,
dhe, si atë, vargjet e mi
njerëzit t'i kuptojnë.

Kudo atë unë e takoj,
në udhë,
në punë
dhe në lulishte,
kur dal me çupën pasditeve.

Atë, kudo, kudo e kam parë.
Me ne ai përherë
qëndron në radhë;

ne qytetarë
dhe ai për ne gjithmonë mësonjës,
gjithmonë ushtar.

Sa herë hapat e tij dëgjoj,
mendoj,
që atë ritm ta derdh në poezi,
dhe vargu im i thjeshtë të jetë si ai
dhe, si atë, çdo këngën time
njerëzit ta kuptojnë,
dhe, si atë, këngën time ta dojë çdo njeri
ta dojë si këto vargje
policin tonë të ri
që kemi festave, n'uzinë,
në ditët e punës, edhe në lagje.

KUDO TË KAM PARË, O SHOK

Buzëgaz
të kam parë kudo.
Ditëve të pranverës, duke ecur
në arat me grurë,
në rrugët e gjata shkëmbore,
dhe dimrit
në baltra,
të lagur, të dërsirë,
në pyjet e dendura,
kur furtunë ka, dëborë e shi,
në piskun e vapës,
kudo të kam parë, o shok, buzëgaz.
Dhe kur zjarri shpërthen
diku,
diku larg, në skaj të lokalitetit,
(e ti nuk ke qenë, jo, andej,) *
si era gjendesh aty.
Kur vërshon lumi i egërsuar,
e përmytja sa fillon,
aty gjendesh përsëri,
o shok, ti.

Në vendet më të vështira
ti hidhesh i pari
sympatrembur
dhe pas të vijnë
punëtori, fshatari.
Në fabrikë,
mes punëtorëve të shoh.
Ata të përshëndesin me zemër
dhe ti u flet «puna mbarë»
secilit në emër.
Aty, mes shokëve punëtorë
të lumtur në punë
dhe ti, në kujtesën e tyre,
lë buzëqeshjen tënde.
Fëmijën miturak papritur
kur ujët e përpinte,
e çonte drejt vdekjes,
dhe nëna e tij, që s'dinte gjë,
rrinte shkujdesur në shtëpi,
ti, o shok i policisë,
u hodhe pa përtuar
drejt rrymës
dhe lumit i the: jo,
fëmija është e jetës!
Edhe fëmija,
kur po zgjohej nga kllapia,
kur hapi syt'e jetës dytë,
ty të pa, o shok,
që si prind i rrije mbi kokë.

ÇASTE PUNE

Mëngjzave në agim,
kur jeta nis rrugën e ditës,
kur shohim t'parat rreze t'dritës
së diellit plot shkëlqim,
përshtëndesim shoshoqnë.

Mëngjzave, sa herë nis rrugën
për punën që më pret,
të shoh ty, njeri, me uniformën blu
dhe n'atë uniformë
edhe në sytë e tu,
o shok, shikoj thjeshtësinë,
mirësjelljen
edhe dashurinë.

Edhe çdo mbrëmje,
kur kthehem në shtëpi,
sërish me uniformën blu
shikoj një njeri.

Ai ecën, edhe qëndron,
edhe vështron.
Un' punën kam mbaruar,
ai punën ka filluar.

Edhe në mesnatë,
kur shtrirë jam në shtrat,
kur librin kam në duar,
poshtë, në trotuar,
ca hapa ndiej.

Ngrihem, vështroj një njeri
me uniformën blu.
dhe ai je ti,
o shok i policisë!

TRYEZA E LËNDËS

	Page
Nënës sime — Pal Mëlyshi	3
Heroi i heshtur — Llazar Siliqi	5
Dy plagë — Llambro Ruçi	8
Syri i pagjumë i kohës — Fotaq Malo	13
Kufitari i parë — Llambro Ruci	20
«Shiko, o Pal...» — Fotaq Malo	22
Hekuran Zenunit — Dhimitër Simaku	24
Po vjen vëllai i trimit — Faik Deda	27
Unë dhe lapidari — Azis Gjergji	31
Mbarë populli bën roje — Beatrice Ballçi	32
Midis tyre edhe unë, kufitari — Elham Pasha	34
Kur vjen komisari — Lirim Deda	35
Shtëpia bri pyllit — Manol Teta	36
Ushitari ynë në kufi — Manol Teta	37
Mos guxo — Manol Teta	38
Piramida dhe lapidari — Namik Dokle	40
Leka — Nikollë Spathari	45
Edhe vdek përgjon në kufi — Pal Perlala	48
Ai asht me ne — Pal Perlala	49
O kangë, jeho — Pjetër Cara	51
Pavdekësi — Skënder Temali	52
Kënga e lirisë — Skënder Temali	54
Tregim për kufitarët — Thanas Peçi	56
Ai — Faik Deda	60
Të përshëndes — Feruze Bajo	63
Polici i trafikut — Ismail Kadare	66
Ai është me ne kudo — Lirim Deda	68
Kudo të kam parë, o shok — Lolo Kume	70
Çaste pune — Polikron Kotini	72

53623.



Tirazhi 2000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp. NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1970